

PARTIA PER DREJTESI INTEGRIM DHE UNITET
T I R A N E

R A P O R T

I EKSPERTIT KONTABEL I REGJISTRUAR
PER FONDET E PERFTUARA DHE TE SHPENZUARA
GJATE VITIT 2013

(USHTRIMI I MBYLLUR ME 31.12.2013)

EKSPERTI KONTABEL I REGJISTRUAR

TEKI FLAMURI

TIRANE , ME 24.05.2014

Teki FLAMURI
AUDIT I PAVARUR
LICENSA Nr : 106
KODI FISKAL L 11314009 E

Tirane , me 24.05.2014

R A P O R T A U D I T I M I

PER AUDITIMIN LIGJOR TE FONDEVE TE PERFTUARA DHE TE SHPENZUARA NGA
PARTIA PER DREJTESI INTEGRIM DHE UNITET GJATE VITIT 2013

DREJTUAR:

KOMISIONIT QENDROR TE ZGJEDHJEVE
Bulevardi "Deshmoret e Kombit" Pallati I Kongreseve

T I R A N E

Te nderuar Zoterinj !

Une kam audituar Pasqyrat Financiare të PARTISE PER DREJTESI INTEGRIM DHE UNITET per ushtrimin e mbyllur më datë 31 Dhjetor 2013 dhe pasqyrën përkatëse të të ardhurave e shpenzimeve për këtë ushtrim, pasqyrën e ndryshimeve ne kapitalet e veta dhe pasqyrën e flukseve te parave per ushtrimin e mbyllur ne ate date, si dhe nje permbledhje te politikave kontabel te rendesishme dhe informacioneve te tjera shpjeguese bazuar ne vendimin Nr.15 date 30.04.2014 te KQZ-se si dhe kontrates se sherbimit te lidhur me Ju me date 05.05.2014.

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare ne perputhje me standartet kombetare te raportimit financiar është përgjegjësi e Drejtimit të shoqërisë. Kjo përgjegjesi perfshin : hartimin , venien ne zbatim dhe mbajtjen e kontrollit te brendshem te pershtatshem per përgatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet te pasqyrave financiare qe jane pa anomali materiale, qofte per shkak te mashtrimit ose gabimit.

Përgjegjësia ime është që, bazuar ne auditimin e kryer, të shpreh nje opinion mbi këto pasqyra financiare. Une e kam kryer auditimin në pajtim me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që të planifikohet dhe të kryhet auditimi për të marrë sigurinë e arsyeshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidence auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen prej gjykimit të audituesit, duke përfshirë vlerësimin e rreziqeve për anomali materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit. Në berjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm përkatës të entitetit në përgatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet të pasqyrave financiare në mënyrë që të hartojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së opinionit për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi gjithashtu përfshin, vlerësimin e përshtatshmerisë së metodave kontabël të përdorura dhe të çmuarjen e rëndësishme të bëra nga Drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithëshme të pasqyrave financiare.

Unë besoj se evidenca e auditimit që kam marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat e opinionit të auditimit.

Opinionimi i audituesit

Sipas opinionit tim, Pasqyrat Financiare paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale të gjendjes financiare të "PARTISE PËR DREJTËSI INTEGRIM DHE UNITET" me datë 31 Dhjetor 2013 performancën e saj financiare dhe të flukseve të parave për ushtrimin e mbyllur në atë datë në përputhje me Standartet Kombëtare të Raportimit Financiar.

AUDITI I PAVARUR

(Teki FLAMURI)

Adresa:

Rruga "Jordan Misja" Tirane
Mobil :069 20 62 970

Permbajtja e raportit te vecante te Auiditit te Pavarur

(Per Pasqyrat Financiare te mbyllura me 31.12.2013)

1. Informacione te pergjitheshme

1.1 Historiku I krijimit

PARTIA PER DEMOKRACI UNITET DHE INTEGRIM (PDIU) eshte themeluar dhe regjistruar si parti politike me Vendimin e Gjykates Nr.9624 date 18.11.2009 dhe vendim te gjykates me Nr.7419 Akti dhe Nr.1498 date 01.03.2011 dhe e regjistruar ne Drejtorine Rajonale te Tatimeve Tirane me NIPT :L 11511451 N .

Kjo parti politike eshte nje organizate politike e pavarur e krijuar ne konformitet te plote me Kushtetuten e Republikes se Shqiperise si dhe te gjithe legjislacionit shqiptar ne fuqi per partite politike. Kjo parti eshte e regjistruar si person juridik me inicialet PDIU .

Me statutin e saj kjo parti politike ka rregulluar menyren e organizimit dhe funksionimit te saj , ka percaktuar organet drejtuese ne nivel qendror dhe lokal . Po ne kete statut jane percaktuar te drejtat dhe detyrimet e antarsise se saj , burimet e financimit te cilat duhet te jene ligjore si dhe rregullat e perdorimit te ketyre fondeve ne dobi te aktivitetit politik te kesaj Partie.

1.2 Organet drejtuese te kesaj partie ne nivel qendror.

- Koventa Kombetare
- Komiteti drejtues Kombetar
- Kryesia
- Kryetari
- Nenkryetari
- Sekretari i Pergjithshem

1.3 Burimet e financimit te kesaj partie

1. Financime nga Buxheti i shtetit .
2. Ndhimat dhe dhuratat e antaresise dhe simpantizanteve te saj.
3. Ndhima dhe dhurata te organizatave partnere.
4. Te ardhura nga Kuotizacionet e antaresise .
5. Te gjitha te ardhurat e tjera burimi i te cilave eshte ne pajtueshmeri te plote me legjislacionin shqiptar per partite politike.

1.4 Baza ligjore per kryerjen e ketij misioni

- Ligji Nr.8580 date 17.02.2000 "Per partite politike" i ndryshuar.
- Ligji Nr.10091 date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor Organizimin e profesionit te ekspertit Kontabel te Regjistruar dhe kontablit te miratuar.
- Standartet Nderkombetare te auditimit dhe kryesisht (SNA) .

- Ligji Nr.9228 date 29.04.2004 "Per kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare"
- Gjithe dokumentacioni ligjor i marre prane Partise Per Demokraci Unitet dhe Integrim.

2. Permbledhje e politikave kontabel

2.1 Bazat e pergatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë pergatitur në përputhje me ligjin shqiptar 'Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato paraqiten ne monedhen vendase, Lek Shqiptar (lek).

Ne paraqitjen e pasqyrave financiare te vitit 2013 eshte zbatuar formati i SKK-2 dhe per rrjedhim zerat e pasqyrave financiare te periudhes krahasuese 2012 jane te krahasueshme me ato te ushtrimit te mbyllur me 31.12.2013.

2.2 Parimet kontabile më domethënëse që janë pëdorur nga shogeria, janë si më poshtë:

Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme.

Shpenzimet njihen atehere kur ato sigurohen prej te treteve dhe ne te njejtin ushtrim kontabel me te ardhurat e lidhura.

2.3 Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci , zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit në datën e bilancit .

Fitimi ose humbja e porealizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

2.4 Pasivet financiare

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në parà, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

3. Pasqyrat financiare te ushtrimit 2013

BILANCI KONTABEL ushtrimi I mbyllur me 31.12.2013

Ne leke

| | Shenimi nr. | Ushtrimi I mbyllur 31,12,2013 | Ushtrimi I mbyllur 31,12,2012 |
|------------|---|----------------------------------|----------------------------------|
| A | AKTIVET | | |
| I | Aktive Afatshkurtera | 4 696 138 | 2 045 590 |
| | Aktive monetare | 4 696 138 | 2 045 590 |
| | Detyrime aktive dhe aktive te mbajtura per tregtim | | |
| | Aktive te tjera financiare afatshkurtera | | |
| | Inventari | | |
| | Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra | | |
| | Totali I Aktiveve afatshkurtera(I) | 4 696 138 | 2 045 590 |
| II | Aktive Afatgjata | | |
| | Investimet financiare afatgjata | | |
| | Aktivete afatgjata materiale | | |
| | Totali I Aktiveve Afatgjata (II) | | |
| | TOTALI I AKTIVEVE (I+II) | 4 696 138 | 2 045 590 |
| B | DETYRIMET DHE KAPITALI | | |
| I | Detyrime Afatshkurtera | 104 730 | 0 |
| | Te pagueshme ndaj furnitoreve | 104 730 | 0 |
| | Grantet dhe te ardhurat e shtyra | | |
| | Provizionet afatshkurtra | | |
| | Totali I Detyrimeve afatshkurtera (I) | | |
| II | Detyrime Afatgjata | 4 591408 | 2 045 590 |
| | Huamarrje te tjera afatgjata | | |
| | Provizionet afatgjata | | |
| | Grantet (donatore) | 4 591408 | 2 045 590 |
| | Totali I Detyrimeve Afatgjata (II) | 4 591408 | 2 045 590 |
| | TOTALI I DETYRIMEVE (I + II) | 4 696 138 | 2 045 590 |
| III | KAPITALI | | |
| | Kapitali I rregjistruar (aksionar) | | |
| | Totali I Kapitalit (III) | | |
| | TOTALI I DETYRIMEVE E KAPITALIT (I,II,III) | 4 696 138 | 2 045 590 |

3.1 **Aktive monetare (likuiditete në arke dhe bankë)**

Gjendjet dhe mjetet monetare ne banke dhe arke, ne leke dhe valute, ne datat 31 Dhjetor 2013 dhe 31 Dhjetor 2012 jane si me poshte:

| Emertimi i Llogarise | Monedha | Gjendja ne 31.12.2013 | | Gjendja ne 31.12.2012 | |
|----------------------|---------|-----------------------|-----------|-----------------------|-----------|
| | | Ne leke | Ne valute | Ne leke | Ne valute |
| Llogari bankare | LEK | 4,696,138 | - | 2,045,590 | - |
| Arka ne leke | LEK | - | - | 0 | - |
| Shuma | | 4,696,138 | x | 2,045,590 | x |

Gjendjet e llogarive te likuiditeteve te paraqitura ne pasqyrat financiare jane te njejta me te dhenat e kontabilitetit rrjedhes dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare me 31.12.2013.

Gjendja e mieteve monetare sipas bankave eshte si me poshte;

| Nr | Banka | Pershkrimi | 31.12.2013 |
|----|--------------------------|-----------------------|------------------|
| 1 | Banka Kombetare Tregtare | Llogari rrjedhese ALL | 4 696 138 |
| | | | |
| | TOTALI | | 4 696 138 |

3.2 . Huate dhe parapagime

| | Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013 | Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012 |
|---------------------------------|---------------------------------------|---------------------------------------|
| Huatë afatgjata | | |
| (i) Tepagueshme ndaj furnitorve | 104,730 | 0 |
| (ii) Grante e donatore | 4,591,408 | 2,046,590 |
| Shuma | 4,696,138 | 2,046,590 |

Detyrimi per t'u paguar ndaj furnitoreve ne shumen 104 730 leke, dhe 4 591 408 leke donacione perfaqesojne tepricen e burimeve financiare ne raport me shpenzimet- shume e cila mbas likuidimit te detyrimeve ndaj furnitorit barazohet me mjetet monetare , qe do te mbeten ne banke.

4. Te ardhurat dhe shpenzimet

PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE
(ushtrimi I mbyllur me 31.12.2013 2013)

| | | Shenim nr | Ushtrimi I mbyllur | Ushtrimi I mbyllur |
|-----------|----------------------------|-----------|--------------------|--------------------|
| | | | 31,12,2013 | 31,12,2012 |
| I | Te ardhurat | | 9 690 346 | 1 222 050 |
| 1 | Donacione ose sponsorizime | | 9 686 431 | 1 220 000 |
| 2 | Interesa bankare | | 3 915 | 2 050 |
| II | Shpenzimet | | 7 144 528 | 1 222 050 |
| 1 | Shpenzime te tjera | | 7 141 170 | 1 220 000 |
| 2 | Komisione bankare | | 3 358 | 2 050 |
| | Teprice fondesh | | 2 545 818 | 0 |

4.1 Te ardhurat

Te ardhurat e realizuara gjate ushtrimit 2013 , sipas burimeve paraqiten ne vijim:

| | | Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013 |
|-------------------------------------|--|---------------------------------------|
| Nga buxheti I shtetit | | |
| Nga donacionet shteti | | 7,866,431 |
| Donacione nga antare e simpatizante | | 1,820,000 |
| Te ardhura financiare nga interesar | | 3,915 |
| Shuma | | 9,690,346 |

Me te detajuara te ardhurat e ushtrimit 2013 jane si me poshte:

| Nr | Indetiteti I Donatorit | Data e financimit | Shuma leke |
|----|-----------------------------------|-------------------|------------------|
| 1 | Buxheti I shtetit (Fonde Publike) | 19.08.2013 | 7,257,231 |
| 2 | Buxheti I shtetit (Fonde Publike) | 19.08.2013 | 609,200 |
| 3 | Beqir Xheladin Nuredini | 04.04.2013 | 900,000 |
| 4 | Arjan Qerim Cukaj | 20.05.2013 | 420,000 |
| 5 | Xhavit Petrit Pinari | 27.05.2013 | 500,000 |
| | Shuma | 0 | 9,686,431 |

Te ardhurat nga buxheti ne shumen 7 257 231 leke jane perfituar ne datat respektive ,si me siper, nepermjet llogarise bankare . Donacionet nga tre qytetaret jane marre CASH duke u dokumentuar ne hyrjet e arkes ne shumen 1 820 000leke.Ne pasqyrat vjetore do te ishte me e drejte qe te paraqitej si ne te ardhurat ashtu edhe ne shpenzime pjesa e reklames televizive e bere falas nga "Top Channel" ne shumen 1 052 400 leke.Kjo nuk ka sjelle deformim te pasqyrave

financiare , pasi nuk eshte shoqeruar me levrim fondesh dhe per pasoje tepricat e llogarive nuk ndryshojne .

4.2 . Shpenzimet e veprimtarise kryesore

Konsumi i materialeve,mallrave, furniturave dhe sherbimeve, te pasqyruara ne dokumentat justifikuese, jane rregjistruar me shumet e paguara ose te pagueshme.

Taksat lokale , taksa e tatime te tjera jane llogaritur dhe pasqyruar ne llogarite e ushtrimit. Sipas natyres se tyre shpenzimet e ushtrimit 2013 jane treguar ne pasqyren perkatese:

Shpenzimet e ushtrimit 2013

| Nr | Furnitori | Pershkrimi | shuma |
|----|--------------------------|-----------------------|-----------|
| 1 | Dr sherbimeve qeveritare | Qera salle | 540,000 |
| 2 | 'SCREEN AD" sh.p.k. | Publicitet ne media | 350,000 |
| 3 | MULTI MEDIA STUDIO NOSIT | Publicitet ne media | 400,000 |
| 4 | "ORA NEWS" | Publicitet ne media | 1,128,640 |
| 5 | "Fest Service"sh.p.k. | Ndricim - foni | 435,000 |
| 6 | Redi Zylfo Person Fizik | Materiale Publicitare | 134,700 |
| 7 | Euro Audit | Ekspertize fondesh | 108,000 |
| 8 | "ORA NEWS" | Publicitet ne media | 2,120,100 |
| 9 | "Top Channel" | Publicitet ne media | 452,400 |
| 10 | "Top Channel" | Publicitet ne media | 533,333 |
| 11 | Materiale nga importi | Materiale Publicitare | 829,083 |
| 12 | CEZ | Energji elektrike | 109,914 |
| | | | |
| | Totali I Shpenzimeve : | | 7,141,170 |

Nga 7 141 170 leke qe jane gjithë shpenzimet e ushtrimit 2013 ,vetem fondet e fushates zgjedhore te 23.06.2013 arrijne ne shumen 6 920 496 leke ,pra pas kesaj periudhe jane kryer vetem 220 674 leke , te cilat konsistojne ne pagesen e Auditit per fondet e fushates ne shumen 108 000 leke , shpenzimet per energjine elektrike 109 914 leke si dhe shpenzimet per komisionerite bankare .

Per marrjen dhe perdorimin e fondeve publike si edhe donacioneve te tjera ,qe I perkasin fushaten zgjedhore te dates 23.06.2013 , gjeresisht problemet jane trajtuar edhe ne Raportin e Auditimit te leshuar posacerisht per keto fonde nga nga shoqeria Audituese Alb – Audit te dates 10 Nentor 2013.

Tirane , me 24.05.2014

AUDITI I PAVARUR

TEKI FLAMURI